



RAPORT MONITORIMI
Maj-Korrik 2021

AUTOR
Erisa Kryeziu

QENDRESA QYTETARE   National Endowment
for Democracy
Supporting Freedom Around the World
www.qeverisja.qq.com.al

Sporti në Shqipëri, shtojcë e politikave



A e dini se...



Sporti në Shqipëri ka qenë një nga shtyllat kryesore ku mbështetej pushteti dhe ideologjia njëkohësisht, përgjatë periudhës së regjimit komunist.

Zgjidhja me ushtrime gjimnastike, shpeshherë masive edhe për nder të udhëheqësve të kohës ishte rituali i përditshëm i çdo të riu në shkolla dhe jo vetëm. Institucionalizimi i sportit në periudhën komuniste nisi me krijimin e Federatës Sportive Shqiptare më 1945, për të vijuar një vit më vonë me ndërtimin e stadiumit të parë në vend, ai "Qemal Stafa".

¹Referuar të dhënave të kohës, të cilat tanimë i gjen në muzeumet që pasqyrojnë periudhën e regjimit komunist, institucionet me karakter sportiv krijohen e formësohen në vijimësi në vitin 1948 që shënon edhe hapjen e shkollës së parë të fiskulturës, e më vonë Komiteti i Kulturës Fizike e Sportive të Shqipërisë. Më 1957 merr jetë Organizata e Bashkimit të Fizkulturstëve e Sportistëve të Shqipërisë, për të vijuar më pas në 1958 me krijimin e Institutit të Lartë të Kulturës Fizike "Vojo Kushi".



Komiteti Olimpik Shqiptar krijohet më 1959, në të njëjtin vit kur edhe Shqipëria pranohet nga ai ndërkombëtar.

Mirëpo, në një shtet i cili sundohej nga një regjim diktatorial, kurrsesi nuk mund të shpëtonin edhe sportistët nga "syri i mprehtë i partisë". Sportistët duke qenë të angazhuar në lëvizjet jashtë vendit pasi që merrnin pjesë në kampionate dhe organizime ndërkombëtare, ishin edhe personat që kontrolloheshin më shumë nga sigurimi i shtetit.

¹ http://bunkart.al/1/ekspozita_muzeale/sporti-ne-shqiperi-1945-1990

Si funksionon sot sporti në Shqipëri?

Sporti në Shqipëri rregullohet përmes një ligji ²“Për Sportin”, nr.79/2017, të ndryshuar së fundmi në ligji nr.105/2020.

Ligji rregullon marrëdhënien mes institucioneve të pushtetit qendror me organizatat sportive publike apo private, duke pasur në fokus kryesor sigurimin dhe mbrojtjen e të drejtave të shtetasve, të cilët merren me sport.

Në Shqipëri ekzistojnë një sërë entitetesh të cilat janë përgjegjëse apo organizojnë veprimtari sportive për secilën nënfushë të sportit. Si të tilla përmendim Komitetin Olimpik Kombëtar Shqiptar, Organizata Kombëtare Antidoping, federatat sportive, shoqatat sportive, klubet sportive dhe shoqëritë sportive.

Federatat shqiptare sportive janë të disata sikurse:



Federata Shqiptare e Basketbollit



Federata Shqiptare e Volejbollit



Federata Shqiptare e Peshëngritjes



Federata Shqiptare e Atletikës



Federata Shqiptare e Ciklizmit



Federata Shqiptare e Mundjes



Federata Shqiptare e Boksit

² [LIGJI-Nr.-79-2017-PËR-SPORTIN-i-përditësuar-LIGJI-105-2020-web.pdf](#)



Federata Shqiptare e Notit



Federata Shqiptare e Xhudos



Federata Shqiptare e Qitjes Sportive



Federata Shqiptare e Tenisit, Federata Shqiptare e Gjimnastikës



Federata Shqiptare e Pingpongut



Federata Shqiptare e Karatesë



Federata Shqiptare e Skive



Federata Shqiptare e Alpinizmit dhe Turizmit Malor



Federata Shqiptare e Taekwondo World.

Federatat sportive, Komiteti Olimpik Shqiptar dhe Organizata Antidoping financohen nga fonde të buxhetit të shtetit apo burime të tjera të ligjshme.

Cilat janë detyrat e këtyre entiteteve sportive?

Federatat:

Referuar ligjit "Për Sportin", federata shqiptare e një sporti të caktuar, qoftë futboll, basketball, xhudo etj. ka për detyrë që të organizojë e vëzhgojë të gjitha aktivitetet sportive zyrtare në nivel kombëtar si dhe të organizojë kampionatin kombëtarë për sportin që përfaqëson dhe të shpallë ekipin kampion kombëtar për sportin përkatës.

Shoqatat sportive:

Në parim shoqatat sportive kanë qëllim të marrin pjesë në veprimtari sportive dhe funksionojnë duke u mbështetur në Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë. Shoqatat sportive nuk mund të zhvillojnë apo marrin pjesë në veprimtari sportive pa qenë anëtare të federatës së sportit përkatës.

Shoqëritë sportive:

Veprojnë dhe aderojnë njëjtë sikurse shoqatat sportive, veçse mbështeten në legjislacionin për shoqëritë tregtare.

Klubet sportive:

Funksionojnë dhe organizohen njëjtë sikurse organizatat jofitimprurëse ose shoqëritë tregtare.

Komiteti Olimpik Kombëtar Shqiptar:

Është një organizatë e pavarur jofitimprurëse, e cila drejton lëvizjen olimpike në Shqipëri

Organizata Kombëtare Antidoping:

Është organizata jofitimprurëse që ushtron veprimtarinë kundër dopingut në Republikën e Shqipërisë.

Sporti, një aneks joprioritar i ministrive

Përgjatë të gjithë historikut të shpërndarjes së kompetencave të ministrive përkatëse, sporti në Shqipëri është parë gjithmonë si një "shtojcë" që i vihej nga pas ministrive, kryesisht dhe më së shumti asaj të Arsimit.

Thënë kjo, edhe në retorikën apo ligjërimin publik e politik të ministrisë përkatëse prania e sportit ka qenë e pakët, për të mos thënë inekzistente.

Për të përforcuar këtë konkluzion, me lehtësinë që të japin edhe rrjetet sociale mund të vëresh fare lehtë rëndësinë që i jepet sportit në këto ligjërime. Mjafton të lëvizësh mes postimeve të Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë (e cila megjithëse e fillë nuk është e shkruar saktë, duke i munguar një presje që ndan arsimin me sportin) në rrjetin social Facebook, për të kuptuar këtë konstatim.

Sigurisht që ashtu sikurse e kemi vënë re edhe në monitorime të tjera të komunikimit në faqet zyrtare të institucioneve në Shqipëri, edhe në këtë rast faqet zyrtare janë thjesht kanal transmetimi i një mesazhi të postuar fillimisht nga drejtuesit e tyre. Kësisoj në të gjithë soditjen e faqes ke të aktivizuar përmes postimeve vetëm formatin "share" (shpërndarje postimesh).

Vitet e vrojtura me lupë, ndoshta nuk përkojnë me më të mirën e mundshme, duke qenë se kishim dhe jemi në një periudhë pandemie, mirëpo shërben si një formë monitorimi.

Nëse do të shikojmë me kujdes ³faqen zyrtare të Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë në Facebook për vitin 2020 dhe 2021 (deri më tani), shohim që vëmendja ndaj sportit përmes postimeve është minimale për të mos thënë inekzistente.

Referuar të dhënave të grumbulluara nga vëzhgimi shohim që përgjatë **2020-ës** kemi në total **1191 postime**. Nga këto postime **582** prej tyre janë të karakterit të përgjithshëm sikurse pakti për universitetin, matura shtetërore, dita e edukimit, festat apo ngjarjet e shënuara kalendarike, portali "Mësues për Shqipërinë", takime me përfaqësues diplomatikë e pasqyrime takimesh e konferencash për arsimin.



Ndërsa **356 postime** i përkasin zhvillimeve rreth pandemisë së shkaktuar nga COVID-19, duke mos harruar këtu informacionit rreth masave të marra, higjena në klasa, njoftime për mësimin online nga shtëpia, e së fundmi edhe

³ <https://www.facebook.com/arsimitsportitdherinise>

njoftime për humbjen nga jeta të mësuesve e pedagogëve pjesë e sistemit arsimor shqiptar.

Ndërsa **229 postime** i përkasin RTSH shkollës, një iniciativë e ngritur me qëllim ndihmën në mësimdhënie në kushtet kur mësimi u zhvillua online. Në këtë numër postimesh përfshihen të dhënat për oraret dhe lëndët e mësimin të përcjella përmes “RTSH Shkollë” si dhe video të mësuesve duke shpjeguar temat e secilës lëndë që mbulonin.

Në totalin e postimeve, **18** prej tyre e zinin raportet javore për punën e Ministrisë. Ndërsa postimet për sportin për të gjithë vitin 2020 ishin vetëm **gjashtë**.



Këto postime kishin karakter të përgjithshëm sikurse postim të mësuesve të edukimit fizik pjesëmarrës në platformën “Mësues për Shqipërinë”, postime informuese për projektin sportiv “STAR” si dhe për “Javën Europiane të Sportit” dhe për Ligën Unike të Basketbollit Shqiptar.

Nr. Karakteri i postimeve në faqen zyrtare në Facebook të Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë. Viti 2020

1.	Postime të përgjithshme	582
2.	Postime për pandeminë e shkaktuar nga COVID-19	356
3.	Postime për njoftime dhe vijmësi të RTSH Shkolla	229
4.	Postime për raportet javore të Ministrisë	18
5.	Postime me karakter sportiv	6

Përgjatë vitit 2021, deri më tani janë gjithsej **278** postime në faqen zyrtare në Facebook.

Ndarja e tyre sipas karakterit të ngjarjes janë si më poshtë:

Nr.	Karakteri i postimeve në faqen zyrtare në Facebook të Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë.	Viti 2021
1.	Postime të përgjithshme	218
2.	Postime për pandeminë e shkaktuar nga COVID-19	29
3.	Postime për njoftime dhe vijimësi të RTSH Shkolla	2
4.	Postime për raportet javore të Ministrisë	15
5.	Postime me karakter sportiv	14

Ajo çka vihet re përgjatë vitit 2021 është fakti se ka një shtim të ngjarjeve dedikuar sportit. Mirëpo kjo lidhet edhe me faktin se tanimë janë duke u zhvilluar lojërat olimpike "Tokio 2020" dhe Shqipëria ka dërguar delegacionin e saj të sportistëve. Gjë kjo e cila është përcjellë përmes komunikimit online të Ministrisë. Megjithatë, edhe pse një numër në rritje, karakteri i postimeve është më së shumti për ceremoninë e nisjes së përfaqësuesve sportivë të Shqipërisë në Tokio, takime me sportistë të rinj dhe postime nga takimet e ministres Evis Kushi në Tokio.

Asnjë mbështetje ndaj sportit përgjatë pandemisë

Shqipëria shënoi rastet e para me virusin COVID-19 më 9 mars të 2020, e si pasojë pati një ngrirje të të gjitha ngjarjeve dhe aktiviteteve kulturore, sportive, organizimeve publike, veprimtarisë së bizneseve, bar-restorantet, palestrat, këndet e lojërave dhe kufijtë tokësorë dhe pjesërisht ata ajrorë.

Në vijim të kësaj u shpall edhe gjendja e fatkeqësisë natyrore, duke vijuar ecuria ekonomike me kapacitet të përgjysmuar.

Përgjatë kësaj periudhe, ashtu sikurse edhe shumë aktivitete të tjera sporti ishte në mesin e tyre që u "paralizuan" në aftësinë për të mbledhur njerëz dhe organizuar ngjarje sportive. ⁴Qeveria shqiptare miratori një sërë paketash ekonomike që do ti vinin në ndihmë qytetarëve dhe entiteteve ekonomike private e shtetërore, duke e ndarë ndihmën në dy paketa mbështetëse me një vlerë të përgjithshme prej 45 miliardë lekësh.

⁴ https://financa.gov.al/raporte-per-covid-19/?fbclid=IwAR0XA-SOEil1i0e_bVEnTWXp2qa471Ygh8sRjmrhVErVsJ654Bfw3gm4JB0

Paketa e parë ndihmëse:

1 Bizneset me të ardhura vjetore deri në 14 milion lekë, të cilat u mbyllën si rezultat i kufizimeve që u vendosën mbi bizneset (u mbyllën) nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale - kjo masë përfshinte rreth 30,000+ subjekte, punonjësit e të cilëve do të përfitojnë pagesa mujore të barabarta me pagën minimale (26,000 lekë) gjatë muajve prill, maj dhe qershor 2020. Individët me të ardhura personale vjetore mbi 2 milion lekë nuk përfitojnë një mbështetje të tillë. Është e rëndësishme të theksohet se kjo masë përfshin të vetpunësuarit dhe anëtarët e paguar të familjes të cilët nuk do të mund të përfitonin ndihmën e papunësisë.



2 Përfituesit e ndihmës ekonomike - kjo masë përfshiu **60,750 familje**, përfitues të Ndhimës Ekonomike, të cilat do të marrin dyfishin e masës së përfitimit (zgjerimi vertikal) në muajt prill, maj dhe qershor 2020. Deri tani janë kryer pagesat për muajt prill, maj dhe qershor.

3 Përfituesit e pagesës së papunësisë - kjo masë përfshin **3,100** përfitues të pagesës së papunësisë, të cilët do të marrin dyfishin e masës së përfitimit (zgjerimi vertikal) në muajt prill, maj dhe qershor 2020. Deri tani janë kryer pagesat për muajt prill, maj dhe qershor.

Paketa e dytë ndihmëse:

3 40.000 lekë ndihmë financiare për të gjithë të punësuarit (të deklaruar në sistemin tatimor në atë kohë) në subjektet me të ardhura vjetore deri në 14 milionë lekë, që janë lejuar të kryejnë aktivitete ekonomike, (me përjashtim të avokatëve, noterëve, tregtisë e produkteve ushqimore, farmaceutike, etj) - kjo masë synon punonjësit e subjekteve të cilët u përballën me një rënie drastike të aktivitetit ekonomik, si rezultat i reduktimit të orëve të punës dhe rënies së kërkesës.



4 40.000 lekë ndihmë financiare për të gjithë të punësuarit (të deklaruar në sistemin tatimor në atë kohë) në të gjitha strukturat akomoduese aktive në fillimin e emergjencës - kjo masë synonte në gjitha llojet e strukturave të akomodimit, një sektor që pësoi rënie të ndjeshme.



5 40.000 lekë ndihmë financiare për të gjithë të punësuarit në Rafinerinë e Ballshit - një masë që synoi 2 subjekte.



SHËNIM: 903 milion lekë shtesë janë paguar për 22.588 përfitues në 3,212 ndërmarjet që kanë parashtruar ankesa dhe të cilat u vlerësuan të pranueshme për të marrë përfitimin.

Nga gjithë përfituesit, sporti sikurse edhe artistët e pavarur nuk u përfshinë në paketat ndihmëse.

Përfaqësues të ekipeve sportive dhe federatave në atë kohë kërkuan mbështetje nga qeveria në kohën kur situata financiare po bëhej alarmante dhe aktivitetet e tyre ishin të bllokuara totalisht, e si rrjedhojë nuk kishin as sponsora.

“Shumicën e ekipit i kam të grumbulluar në hotel, 8 janë të huaj. Kam trajnerin me gjithë familjen e tij. Gjithashtu edhe disa futbolliste janë këtu me familjet e tyre”, - u shpreh për mediat presidenti i ekipeve të Bylisit, Besnik Kapllanaj në prill të 2020.

Po ashtu mungesa e aktiviteteve sportive kombëtare krijoi problematika sa i përket angazhimit të skuadrave shqiptare ndërkombëtarisht, kjo si pasojë e mungesës së kushteve për t'u stërvitur.

Ndryshe nga Shqipëria, Kosova shfrytëzoi fondin emergjent me qëllim mbështetjen e sportit në vecanti. **1 milion e 539 mijë euro** ishte fondi i shpërndarë për sportin në Kosovë për ta mbështetur gjatë pandemisë. Nga ky fond përfituan **627 klube sportive** nga të gjitha kategoritë e tyre si dhe përfituan drejtpërdrejt **26.000 sportistë** që ushtrojnë aktivitetin e tyre në këto klube.



⁵ https://euronews.al/al/sport/2020/04/02/besnik-kapllanaj-situatet-e-veshtire-dhe-alarmante-ne-futboll/?fbclid=IwAR0KIJWcCAQM04ojkoKHVIG_grD908WTX1Oz1Hdi05hPKc7yYCAJqOfuDLK

Mbështetja financiare për sportin në 5 vitet e fundit

Shqipëria është një vend në zhvillim dhe si e tillë buxhetet që ajo akordon për secilën ministri përkatëse kanë tendencë rritjeje, për aq kohë sa synojmë mirëqënien ekonomike. Njëjtë me ministrinë e tjera edhe Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë ndër vite ka një rritje të buxhetit të saj.

Për të kuptuar këtë mjaft të shohim buxhetet që kjo ministri ka pasur në 5 vitet e fundit, prej vitit 2016 deri më 2020.

Përkatësisht, për vitin 2016, buxheti i rishikuar për Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë ishte **35 miliardë e 557.6 milionë lek**.

Nr	Emri i programit	Buxheti I miratuar PBA 2016	Buxheti I miratuar per 2016	Buxheti Rishikuar r 2016	Struktura	Realizimi 12- mujor 2016		
		(milion lekë)	(milion lekë)	(milion lekë)	Në %	Në milion /lekë	Realizimi ne % ndaj planit	Struktura e programit ne % ndaj realizim të MAS
1	Planif.menaxhim administrim	834.0	834.0	775.4	2.2%	756.6	98%	2.2%
2	Arsimi baze	24,727.7	21,126.4	20,472.4	57.6%	20,002.3	98%	57.8%
3	Arsimi i mesem pergjith	7,054.0	6,902.6	6,701.8	18.8%	6,574.3	98%	19.0%
4	Arsimi profesional	0.0	0.0	0.0	0.0%	0.0	0%	0.0%
5	Arsimi i larte	6,898.0	6,798.0	6,428.0	18.1%	6,198.5	96%	17.9%
6	Kerkimi shkencor	300.8	300.8	353.8	1.0%	343.4	97%	1.0%
7	Programi per Sportin	476.5	476.5	826.2	2.3%	759.9	92%	2.2%
	Totali	40,291.0	36,438.3	35,557.6	100.0%	34,635.1	97%	100.0%

Për vitin 2017, buxheti i rishikuar për Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë ishte **36 miliardë e 333.6 milion lekë**.

Fondet e buxheti 2017										
Nr	Emri i programit	Fakti 2016	Buxheti I mmirat PBA 2017	Buxheti I miratuar per 2017	Buxheti Rishik 2017+Te ardhurta	Buxheti 12 mujor 2017+Te ardhurta	Struktura	Realizimi 12- mujor 2017		
		(milion lekë)	(milion lekë)	(milion lekë)	(milion lekë)	(milion lekë)	Në %	Në milion /lekë	realizim ne % ndaj buxhetit te rishikuar	Struktura ne % ndaj realizim
1	Planif. menaxhim administrim	745.7	772.0	715.0	716.4	716.4	2.0%	662.2	92%	1.9%
2	Arsimi bazë	19,956.1	21,008.1	20,477.3	21,059.3	21,059.3	58.0%	20,719.4	98%	58.5%
3	Arsimi i mesem pergjith	6,571.7	6,822.6	6,333.3	6,866.7	6,866.7	18.9%	6,689.7	97%	18.9%
4	Arsimi profesional	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0%	0.0	0%	0.0%
5	Arsimi i larte	6,198.5	6,813.0	6,643.0	6,971.3	6,971.3	19.2%	6,687.0	96%	18.9%
6	Kerkimi shkencor	283.0	415.8	365.8	394.7	394.7	1.1%	359.5	91%	1.0%
7	Zhvillimi i Sportin	751.9	486.5	186.6	325.2	325.2	0.9%	292.5	90%	0.8%
	Totali	34,506.9	36,318.0	34,721.0	36,333.6	36,333.6	100.0%	35,410.3	97%	100.0%

⁶ <https://arsimi.gov.al/buxheti-dhe-financat/>

Ndërsa për vitin 2018 buxheti i rishikuar për Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë ishte **38 miliardë e 322.8 milionë lekë**

Fondet e buxheti 2018											
Nr	Emri i programit	Fakti 2016	Fakti 2017	Buxheti Mirat PBA 2018	Buxheti I miratuar per 2018	Buxheti Rishik 2018+Te ardhurta	Buxheti Rishik 2018+Te ardhurta	Struktura	Realizimi 8- mujor 2018		
		(milion lekë)	(milion lekë)	(milion lekë)	(milion lekë)	(milion lekë)	(milion lekë)	Ne %	Ne milion /lekë	realizim ne % ndaj buxhet	Struktura ne % ndaj realizim
1	Planif. menaxhim administrim	745.7	657.6	717.0	797.0	743.4	743.4	1.9%	663.4	89%	1.8%
2	Arsimi baze	19,956.1	20,692.0	21,177.3	22,174.5	22,055.1	22,055.1	57.6%	21,825.4	99%	58.2%
3	Arsimi i mesem pergjith	6,571.7	6,688.3	6,193.3	7,094.7	6,959.7	6,959.7	18.2%	6,845.4	98%	18.3%
4	Arsimi profesional	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0%	0.0	0%	0.0%
5	Arsimi i larte	6,198.5	6,687.0	6,745.0	7,305.2	7,536.3	7,536.3	19.7%	7,204.0	96%	19.2%
6	Kerkimi shkencor	283.0	325.6	630.6	480.4	380.5	380.5	1.0%	318.2	84%	0.8%
7	Zhvillim i Sportit	751.9	278.7	487.9	522.3	647.9	647.9	1.7%	629.0	97%	1.7%
Totali		34,506.9	35,329.3	35,951.1	38,374.2	38,322.8	38,322.8	100.0%	37,485.4	98%	100.0%

Për vitin 2019, buxheti i rishikuar për Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë arriti në shifrën **44 miliardë e 732.8 milion lekë**.

Fondet e buxheti 2019 se bashku me te ardhurat 2019											
Nr	Emri i programit	Fakti 2016	Fakti 2017	Fakti 2018	Buxheti Mirat PBA 2019	Buxheti Mirat Ligj nr.99/2018 per vitin 2019	Buxheti I rishik+ Te ardhurat per 2019	Buxheti Rishik 12- M 2019+Te ardhurat	Struktura e fondeve per 12-mujorin 2019+Te ardhurat	Buxheti Realizuar 12 M 2019+Te ardhurat	Realizimi 12-mujor 2019
		(milion lekë)	(milion lekë)	(milion lekë)	(milion lekë)	(milion lekë)	(milion lekë)	(milion lekë)	(milion lekë)	Ne %	Ne milion /lekë
1	Planif. Menaxhim	756.6	662.2	797.0	797.0	797.04	800.2	800.2	1.8%	754.9	94%
2	Arsimi baze	20,002.3	20,719.4	22,508.5	22,508.5	22,508.50	23,061.2	23,061.2	51.6%	22,482.3	97%
3	Arsimi i mes pergjithshem	6,574.3	6,697.7	7,286.6	7,286.6	7,286.64	7,487.8	7,487.8	16.7%	7,161.9	96%
4	Arsimi i profesional	0.0	0.0	0.0	0.0	7,287.64	0.0	0.0	0.0%	0.0	96%
5	Arsimi i larte	9,530.9	9,719.2	10,506.9	7,455.0	7,455.0	12,121.6	12,121.6	27.1%	11,616.6	96%
6	Kerkimi shkencor	343.4	359.5	414.9	620.0	620.0	792.8	792.8	1.8%	507.2	64%
7	Programi per Sportin	759.9	292.5	500.0	468.0	468.00	469.3	469.3	1.0%	448.8	96%
Totali		37,967.5	38,450.6	42,013.9	39,135.1	46,422.786	44,732.85	44,732.8	100.0%	42,971.7	96%

Ndërsa për vitin 2020 buxheti i rishikuar për Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë ishte **44 miliardë e 420.9 milionë lekë**, duke përfshirë këtu edhe të ardhurat e trashëguara nga vitit 2019.


Fondet e buxheti 2020 se bashku me te ardhurat 2020											
Nr	Emri i programit	Fakti 2016	Fakti 2017	Fakti 2018	Fakti 2019	Buxheti Mirat 2020	Buxheti rishikuar	Buxheti I rishik+ Te ardhurat per 12-M 2020	Buxheti Realizuar 12 M 2020+Te ardhurat	Struktura e fondeve per 12-mujorin 2020+Te ardhurat	Realizimi 12-mujor 2020
		(milion lekë)	(milion lekë)	(milion lekë)	(milion lekë)	(milion lekë)	(milion lekë)	(milion lekë)	(milion lekë)	Ne %	Ne milion /lekë
1	Planif. Menaxhim	756.6	662.2	665.8	754.9	735.0	691.4	695.3	620.6	1.5%	89%
2	Arsimi baze	20,002.3	20,719.4	21,860.8	22,482.3	23,320.7	22,803.4	22,861.8	22,206.1	52.6%	97%
3	Arsimi i mes pergjithshem	6,574.3	6,697.7	6,855.5	7,161.9	7,364.0	6,986.3	6,986.3	6,834.7	16.2%	98%
4	Arsimi i profesional	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0%	98%
5	Arsimi i larte	9,530.9	9,719.2	10,506.9	11,616.6	9,730.0	10,024.9	12,761.0	11,548.7	27.4%	90%
6	Kerkimi shkencor	343.4	359.5	414.9	507.2	500.0	680.2	867.4	802.0	1.9%	92%
7	Programi per Sportin	759.9	292.5	675.5	448.8	330.0	248.3	249.1	209.3	0.5%	84%
Totali		37,967.5	38,450.6	40,979.2	42,971.7	41,979.76	41,434.60	44,420.94	42,221.4	100.0%	95%

Krahasuar buxhetet ndër vite, vëmë re se rritja është e lehtë.


⁷ [0-2019-Raporti-i-Monit-12-M-Janar-31dhjetor-2019-FN_Final-28.2.2020.pdf](#)

⁸ [12-Raporti-i-Monitorimi-12_M-Janar-31-Dhjetor-2020_Final-01.03.2021_FN.pdf](#)

Buxhetet për Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë 2016-2020



Buxheti për Sportin (milion lekë)



Ministria i ndan fondet e saj në gjashtë zëra apo kategori:

- Fonde për planifikimin, menaxhimin dhe administrimit
- Fonde për arsimin bazë, pra atë parashkollor,
- Fonde për arsimin e mesëm të përgjithshëm
- Fonde për arsimin universitar,
- Fonde për shkencën
- Fonde për zhvillimin e sportit dhe rinisë.

Ajo çka vihet re nga shpërndarja e fondeve sipas kategorive është fakti se fondi për zhvillimin e sportit dhe rinisë mbetet ndër vite **më i ulëti krahasuar me kategoritë e tjera të ndarjes së fondeve.**

E megjithë këtë, mbështetja për sportin në buxhet, ka pësuar rënie edhe në krahasimin e mbështetjes ndër vite për këtë fushë. Nëse do të krahasojmë vitet 2016 deri në 2020, shohim që fondin më të madh nga ministria, sporti e ka marrë në vitin 2016, për të pësuar një ulje të madhe më 2017, e cila vijon edhe përgjatë vitit 2020.

**SHPËRNDARJA E FONDIT GRAND PËR FEDERATAT SHQIPTARE
SPORTIVE OLIMPIKE, KOKSH DHE OKAD 2021**

Tabela 1

Nr.	Emërtimi i Institucionit	FINANCIMI 2021
1	Federata Shqiptare e Basketbollit	18,000,000
2	Federata Shqiptare e Volejbollit	17,500,000
3	Federata Shqiptare e Peshëngritjes	14,500,000
4	Federata Shqiptare e Atletikës	13,000,000
5	Federata Shqiptare e Çiklizmit	12,000,000
6	Federata Shqiptare e Mundjes	10,500,000
7	Federata Shqiptare e Boksit	8,000,000
8	Federata Shqiptare e Notit	7,000,000
9	Federata Shqiptare e Xhudos	6,000,000
10	Federata Shqiptare e Taekwondo World	5,000,000
11	Federata Shqiptare e Qiçjes Sportive	4,000,000
12	Federata Shqiptare e Tenisit	3,000,000
13	Federata Shqiptare e Gjinnastikës	3,000,000
14	Federata Shqiptare e Pingpongut	3,000,000
15	Federata Shqiptare e Karatesë	2,500,000
16	Federata Shqiptare e Skive	2,000,000
17	Federata Shqiptare e Alpinizimit dhe Turizmit Malor	1,000,000
18	Komiteti Olimpik Kombëtar Shqiptar	6,000,000
19	Organizata Kombëtare Antidoping	2,000,000
	TOTAL	138,000,000

Ndërsa për vitin 2021, Ministria ka ndarë një total prej 138,000.000 lekë ndaj federatave shqiptare, Komitetit Olimpik Shqiptar dhe Organizatës Kombëtare Antidoping.

“Ne kemi vullnetin dhe dëshirën e mirë që të bëjmë akoma më shumë për zhvillimin e sportit”

Në një takim të zhvilluar me sportistët e rinj, në qershor të 2021, ministria Evis Kushi u shpreh se nuk mungon dëshira dhe vullneti për të kontribuar për zhvillimin e sportit nga ana e politikbërësve.

Në përgjigjen e një kërkesë për informacion drejtuar Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë na u përgjigjën se sportit po i rikthehen investimet pas një periudhe të gjatë mungesash.

Ministria përmendi në investimet strategjike të saj në sport një sërë projektsh sikurse qendra olimpike “Tirana Olympic Park”, rikonstrukcioni i stadiumit “Elbasan Arena”, rikonstrukcioni i stadiuimit të Shkodrës” Loro Boriçi” dhe stadium kombëtar ‘Air Albania’.

Mirëpo, përpos këtyre investimeve infrastrukturore, ndër vite sportistët kanë shprehur shqetësimet e tyre në lidhje me infrastrukturën e munguar në stervitjet e tyre dhe kushtet e këqija që i kanë shoqëruar.

“Ne nuk kemi vende zhveshje, nuk kemi vende për t'u larë, nuk ka as mbështetje financiare, nuk ka dhe vegla. Gjithçka e kam paguar vetë. E vetmja gjë që na shtyn ne është pasioni”, - u shpreh sportistja e hedhjes së cekicit Nansi Haxhiu për emisionin GenZ në Euronews Albania.

Të njëjtën problematikë shprehu edhe atletja Rexhina Berhami, në takimin me ministren Kushi. Mungesa e një piste tartani për stërvitje i bën atletët të stërviten pa kushtet e duhura.



“Ne konkretisht stërvitemi tek liqeni, ku është një terren jo shumë i mirë si për verë edhe për dimër, domethënë nuk është se kemi pistë tartani. Stadiumi Air Albania vërtetë që është shumë i bukur dhe shumë i mirë, por pista nuk është më siç ka qenë tek Qemal Stafa”.

Shqetësim ky të cilin e ndau edhe vetë ministrja Kushi.

“Një nga sfidat tona më të mëdha në vitet që vijnë është që të investojmë akoma më shumë në infrastrukturën sportive. Dhe pavarësisht se ne i kemi rritur buxhetet për grantin për federatat, shut sikurse edhe buxhetin për infrastrukturën sportive, prapë është i pamjaftueshëm”

Ndërsa, gjatë zhvillimit të lojërave olimpike në Tokio, ku peshëngritësi Briken Calja u rendit i katërti në botë, u ngrit sërish diskutimi për infrastrukturën sportive në Shqipëri.

Kreu i Komitetit Olimpik Shqiptar, Fidel Ylli vuri në dukje mos mbështetjen institucionale ndaj sportistwve.

“Po ta donim ne sportin, këta sportistë do t'i mbanim si uji i pakët. Nuk do të kishte nevojë që Luiza Gega të stërvitej në Kenia me shpenzimet e Komitetit dhe të saj sepse ne nuk kemi pistë tartani, as Kledi Kadiu të stërvitej në SHBA se nuk kemi pishinë olimpike. Këtë infrastrukturë duhet ta bëj shteti, dhe sporti të futet në sistem, ajo lind nga shkollat, dhe nuk mund të bazohemi thjesht tek federatat”.



⁹ https://euronews.al/al/programs/shqiperi/gen-z/2021/05/24/15-vjecarja-nansi-haxhiu-kampionia-e-sportit-ne-zhdukje-ne-shqiperi/?fbclid=IwAR3uzOOHF1_JKFjvstniwnlog0QojgeodXfHv95-cq2XSDxNsBkb10YDYg

Mbështetja e sportit elitare



“A e di kush jam unë që po ju flas? Ilir Suli, Mjeshtër i Madh i Punës nga Presidenti. Ish-nënkampion bote në shtanga. Mbas lashë sportin, jam pa punë. Ikni nga ky vend, kjo ka ngelur vetëm”, - ishin fjalët e ish nënkampionit të botës ndaj një pyetje rutinë të një gazetareje në sheshin ‘Skendërbej.

Njëjtë me Ilir Suli, problematika e mos shpërblimeve për sportin elitare dhe mos gëzimi i një statusi vijon edhe sot, në shqetësimin e shprehur edhe nga sportistja peshëngritëse Kleopatra Saliaj.

Në takimim me ministren Evis Kushi ajo u shpreh:

“Kam marrë pjesë në Kampionatin Europain të të Rinjve që është zhvilluar së fundmi dhe kam dalë kampione Europe. Por jam e pakënaqur sepse nuk jam vlerësuar për asnjë gjë, as nga Federata dhe as nga shteti, për atë c'ka unë kam marrë”.

Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, me ligjin e ri “Për Sportin”, të ndryshuar ka specifikuar rregullimin e kësaj klauzole për trajtimin e sportistit. Sipas nenit 27 të ligjit “Për Sportin”

10“Sportistët që përfitojnë statusin e nivelit të lartë, sipas rezultateve sportive në veprimtaritë ndërkombëtare zyrtare : a) "rekord olimpik", "rekord botëror", "rekord europian", "rekord mesdhetar", "rekord ballkanik", "vendi i parë deri në të tetin në Lojërat Olimpikë", "vendi i parë deri në të tetin në kampionate botërore" dhe "vendi i parë deri në të gjashtin në kampionate europiane", përfitojnë trajtimin, shpërblimin dhe integrimin në sistemin arsimor me drejtim sportiv, sigurisë kombëtare dhe mbrojtjes, punësimin në strukturat e Ministrisë së Mbrojtjes dhe Ministrisë së Brendshme”.

Mirëpo nga ligji deri në praktikë ka akoma punë për të bërë në këtë drejtim.

Në një kërkesë për informacion drejtuar ministrisë nga Qëndresa Qytetare, shohim se pyetjes për mbështetjen e secilës kategori sportisti në aspektin monetar, ministria nuk e shtjellon sipas rastit.

Megjithatë ministria thekson se ka shlyer deri më tani borxhet në masën **150 milionë lekë**, shpërblime këto të munguara ndër vite për sportistët elitare.

Ndërsa po sipas ministrisë, janë akorduar 13.2 milionë lekë për pjesëmarrjen e sportistëve elitare në kompeticionet ndërkombëtare dhe shpërblimet e tyre, duke mos i ndare në përgjigjen e nisur sipas kategorive që permend.

¹⁰ <https://arsimi.gov.al/wp-content/uploads/2019/11/Permbledhese-per-sportin-21.8.2019.pdf>

Edhe në shpërblimet që marrin sportistët në pjesëmarrjen në lojëra olimpike, Kosova sërish ofron më shumë për sportin.

100 mijë euro shpërblime për sportistin/en nëse fiton medalje të artë në olimpiada, 60 mijë euro për medalje argjendi dhe 40 mijë euro për medalje bronxi. Ndërsa për rekorde në Lojërat Olimpike, Kosova siguron 200 mijë euro për sportistët.

Ndërsa Shqipëria jep shpërblime për pozicionet deri në vendin e tetë në gara individuale nga 80 mijë euro deri në 4 mijë euro. Ndërsa për rekordet olimpike e botërore, jep një shpërblim prej 120 mijë eurosh.

Shqipëria nisi në Tokio 9 sportistë për të marrë pjesë në lojërat olimpike "Tokio 2020", shumica prej tyre të stërvitur privatisht apo duke shfrytëzuar infrastrukturën sportive jashë vendit.

Gjetjet kryesore



Në Shqipëri sporti mbetet ende jo prioritar në politikat e ndërmarra nga ministritë përkatëse. Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë edhe pse një ministri që ka mes veti sportin si përgjegjesi institucionale, sërish veprimtarinë e saj në aspektin retorik, ligjërues dhe organizativ e ka të fokusuar më së shumti te arsimi dhe shumë pak te sporti.



Në të gjithë buxhetin vjetor të Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë, sporti mbetet fusha më pak e financuar nga shteti. Buxhet ky i cili nëse krahasohet në 4-5 vitet e fundit ka pësuar rënie në lidhje me sportin.



Përgjatë pandemisë, ashtu sikurse edhe shumë fusha të tjera sikurse arti dhe artistët, sporti ishte një tjetër sferë që vuajti pasojat e COVID-19 për shkak të pezullimit të aktiviteteve. Mirëpo, qeveria nuk e përfshiu në paketat ndihmëse sikurse grupet e tjera.



Në Shqipëri infrastruktura për sportin, përpos dëshirës e vullnetit të shfaqur të Ministrisë për të kontribuar, mbetet akoma një gangrenë që i detyron sportistët të mos stërviten në kushtet e duhura e shpesh të sakrifikojnë nga të ardhurat personale.



Përpos mbështetjes që jep ligji i ndryshuar së fundmi "Për Sportin", në praktikë sporti elitari mbetet akoma pa një strategji të mirëfilltë mbështetjeje, duke e kthyer sportin në Shqipëri një sakrificë sublimë për "për nder të flamurit".

Rekomandime



Sporti duhet të marrë një vëmendje më të madhe nga Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë. Kjo arrihet nga shtimi i fondeve për sportin në buxhet si dhe nxitja e të rinjve për pjesëmarrje në sport përmes lehtësirave apo mitivimit financiar.



Duhet më shumë investime në infrastrukturë, qoftë në ofrimin e një piste tartani për atletistët ashtu edhe të një pishine olimprike të cilat mungojnë në vend.



Sporti duhet të ndërtohet si një system ku bashkëpunimi me ministrinë përkatëse, federatat dhe organizatat sportive të jetë kyc për ta shtyrë para zhvillimin e sportit. Nëse nuk ka një strategji konkrete nga ministria, kjo gjë nuk bëhet vetëm nga federatat apo organizatat sportive.



Një formë mbështetjeje për sportin mund të jetë edhe përmes “Ligjit të Sponsorizimeve”, ku sporti lihet i hapur për investime edhe nga privatët apo sponsorët e interesuar. Shembull konkret në këtë pikë mund të ndiqet Kosova, e cila tanimë e ka të aplikueshëm këtë ligj.

#QËNDRESË / MIRËQEVERISJE